



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:113143

Datë: 19.01.2024

Numri i dokumentit: 05211563

C -III- 15- 0188

Paditës/ Propozues : H H B nga Prishtina, përfaqësuar nga V H avokat nga Prishtina.

Kundër :

Të Paditurit/ Kundërshtarë të sigurimit : 1) NSH „ Lapje Sello ” e përfaqësuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rr. Driton Hoxha nr. 55, Prishtinë.

2. M M, nga Prishtina
3. Q S S, nga Presheva,
4. D L, nga Prishtina,
5. M M, S, ,
6. G Q E, nga Prizren,
7. F S H nga fshati B e P, Prishtinë
8. M M S,
9. A R H, nga Prishtina.
10. A G, nga Prishtina.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, me kolegjin e specializuar gjyqtarin kryesues Hasim Sogojeva, dhe gjyqtaret Manushe Karaqi dhe Sylejman Shumolli, në lidhje me propozimin e propozuesit për caktimin e masës së sigurimit, në seancë vendimmarrëse dt. 19 janar 2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si i pa bazuar propozimi i propozuesit H B për caktimin e masës së sigurimit ndaj kundërshtarit të sigurimit Agjencisë Kosovare të Privatizimi/ Autoriteti i Likuidimit NSH Lapje Selo dhe kundërshtarëve të tjerë të sigurimit, M M, Q S s, D L, M M, G Q E, F S, M M, A H dhe A, G .

Rrethanat e Faktike

Më dt. 24.04.2015, është ushtruar ankesa e paditësit kundër Vendimit të Autoriteti të Likuidimit për NSH „, Ratar – Lapje Selo PRN 115- 0188 me të cilin është refuzuar kërkesa pronësore mbi pronat e pa identifikuar si aset i NSH –së .

Në parashtrësë është deklaruar se babai i paditësit i ka blerë këto prona në vitin 1957, dhe atë në vitin 1957, sipas licitacionit paluajtshëmrin e NSH –së, me kulturë arë, me sipërfaqe 0.03.80ha, e evidentuar si ngastra ...f.p..., dhe atë në bazë të Aktvendimit të Sekretariatit për Financa të Këshillit Kombëtar të Komunës së Prishtinës, nr. 11742/57, dhe atë i përberë nga Komisioni prej tre anëtareve . Po ashtu me aktvendimin e Gjykatës së Rrethit në Prishtinë O-nr. 297/1962, dt. 05.03.1963, është shpallur si trashëgimtar i të ndjerës E B R B nipi i të ndjerës , djali i axhsë së paditësit.

Prona në fjalë është pa realizuar në ngastra tjera nr..., dhe..., në vendin e quajtur „U ‘ ‘ FP Ç...

Ka kërkuar të aprovohet ankesa.

Ka bashkangjitur :

- Ekstraktin e lindjes për H B,
- Certifikatën e vdekjes për H B,
- Aktvendimin e Gjykatës së Rrethit në Prishtinë O- nr. 297/62,
- Dokumentin Popis ,
- Procesverbalin e Komisionit,
- Diftesë e përkohshme posedimore e lëshuar nga Shteti Shqiptar , Zyra e Komisionit të Posaçëm , Prefektura Prishtinë , dt.08.04.1944,
- Kontrata e shitblerjes dt. 30.10.1968,
- Aktgjykim, 06.11.1937,
- Aktvendim 1951,
- Fleta e Posedimit, ..., ZK Çagllavicë,
- Fleta e Posedimit, ..., ZK Çagllavicë,
- Kontrata mbi shtijën e palujatshmeris, ...,
- Kontrata për shitje të palujatshmerisë dt.....,
- Kontrata për shitje të palujatshmerisë, dt.....,
- Kontrata për shitje të paluajtshmerisë.

Më dt. 18.10.2017, AKP-ja, përmes përfaqësuesit të saj ka dorëzuar parashtrësën në mbrojtje, ndaj ankesës kundër Vendimit të AL PRN 115- 0188, të AL për NSH Ratar dt. 29.03.2015, me propozim që ajo të refuzohet.

Në parashtrësë është deklaruar se NSH Ratar ka hyrë në procedurë të likuidimit më dt. 11.08.2014, ndërsa më dt. 25.09.2014, paditësi ka ushtruar kërkesë pronësore për ngastra të pa identifikuar. AL mori Vendimin PRN 115- 0188, me të cilën ka refuzuar kërkesën. Para marrjes së Vendimit AL i ka kërkuar më dt. 23.02.2015, paditësit dëshmi, informacione që mbështesin kërkesën e tij , veç të tjerash ju është kërkuar identifikimi i të dhënave të sakta të ngastrës në të cilën kërkohet pronësia.

Ka bashkangjitur :

- Shkresa e H B, dt. 11.03.2015,
- Aktvendimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë C. nr. 853/01, për shpallje jo kompetente,
- Aktgjykimin dt. 20.11.1937,
- Vendimin PRN 115- 0188, dt. 19.03.2015.

Më dt. 15.10.2020, i autorizuari i paditësit avokati V H, ka dorëzuar, parashtresën me të cilën është deklaruar se prindi i H B, e ka blerës këtë pronë në vitin 14.09.1957, me sipërfaqe 0.03.80ha, me nr..., fp..., sipas Aktvendimit të Sekretariatit të Financave të Këshillit Kombëtar të Komunës së Prishtinës nr. 11742/57 . Kjo pronë është e paraardhësit E B, e kurrsesi e S B, dhe si trashëgimtare e saj është shpallur R B, sipas aktvendimit për shqyrtim trashëgimie T nr....., dt.....

Më dt. 20.11.2020, AKP-ja, përmes përfaqësuesit ka dorëzuar parashtresën e kundërpërgjigjes me të cilin ka kundërshtuar pretendimet e të autorizuarit të paditësit.

Më dt. 25.01.2021, DHPGJS ka lëshuar Urdhër për paditësin, dhe të njëjtit ju është kërkuar të plotësoj ankesën si dhe të dorëzojë historiatin e pronës, dhe të identifikon ngastrat me ekspertizë gjeodezike . Paditësi është njoftuar për pasojën e mos veprimit.

Më dt. 01.02.2021, Urdhri ju është dorëzuar avokatit të paditësit V H.

Më dt. 11.02.2021, avokati ka dorëzuar një parashtresë me të cilën ka kërkuar për një afat shtesë për të vepruar sipas Urdhrit .

Më dt. 27.06.2023, i autorizuari i paditësit ka dorëzuar parashtresën me të cilën ka kërkuar caktimin e masë së sigurimit kundër AKP-së dhe M M, por duke mos zgjeruar edhe padinë ndaj M M, edhe pse në këtë procedurë shqyrtohet vetëm ligjshmëria e Vendimit të AKP-së- AL .

Më dt. 04.07.2023, Propozimi për caktimin e masës së sigurimit ju është dorëzuar AKP-së.

Më dt. 11.07.2023, AKP-ja ka dorëzuar parashtresën si përgjigje në propozim të masës së sigurimit, dhe me të njëjtën është deklaruar se nuk ka kushte për caktimin e masës së sigurimit, pasi paditësi- propozuesi nuk e ka bërë të besueshme si kërkesën ashtu edhe rrezikun për dëmin e pa riparueshëm.

Më dt. 21.07.2023, i autorizuari i paditësit ka bërë zgjerimin e propozimit në pikëpamje subjektive, po jo të padisë edhe ndaj personave të tjerë si Q S S, D L, M M, E G, S F, A R A G, por me parashtresë nuk i ka dorëzuar adresat e Kundërshtareve të sigurimit, sikundër parashtresën nuk e ka dorëzuar në kopje të mjaftueshme për të gjithë kundërshtaret.

Me këtë parashtresë ka kërkuar :

Caktohet masa e sigurimit dhe të ndalohet që palujatëshmeria si njësi kadastrale P –..., me sipërfaqe 1160m2, në emër të M M ngastra e pronarit Q S S P –..., me sipërfaqe 13489m2, , pastaj poseduesit faktik D L ngastra ne....., me sipërfaqe 2375m2, M M, ngastra, me sipërfaqe 3060m2, G Q E dhe K F , ngastra nr....., me sipërfaqe 3276m2, F S, ngastra nr. me sipërfaqe 1425m2, M M dhe G A ngastra..., me sipërfaqe 9515m2, A M, ngastra nr....., me sipërfaqe

1425m², M M dhe G A ngastra nr...., me sipërfaqe 950m², të cilat prona gjendet në V, që të mos shiten apo të tjetërsohen duke aprovuar kërkesën e propozuesit.

Ka bashkangjitur : Certifikatën P- ...1, Certifikatën P-..., Certifikatën P-..., Certifikatën Certifikatën P-..., Certifikatën Certifikatën P-..., Certifikatën Certifikatën P- ...-4, Certifikatën P-..., Certifikatën P-....

Më dt. 23.10.2023, DHPGJS ka lëshuar Urdhër për paditësin/propozuesin duke i kërkuar të plotëson parashtrësën edhe me adresa të sakta të kundërshtareve të sigurimit. I autorizuari i propozuesit është njoftuar për pasojën juridike të mos veprimt .

Më dt. 02.11.2023, i autorizuari i propozuesit e ka pranuar Urdhrin.

Më dt. 07.11.2023, i autorizuari i propozuesit ka dorëzuar parashtrësën, me të cilën ka ofruar të dhënat në lidhje me adresën për Kundërshtaret e sigurimit, duke i dorëzuar në ekzemplar të mjaftueshëm propozimin për masë të sigurimit, por përsëri ka dështuar të dorëzojë formularin e kërkesë kreditore, historiatin e pronave, ekspertizën gjeodezike, të sqarohet në lidhje me bazën juridike të kërkesës kreditore, raportin juridik të tij me të paditurin dhe Kundërshtaret e sigurimit.

Arsyetimi ligjor

Propozimi për caktimin e masës së sigurimit nuk ka bazë juridike.

Me dispozitën e nenit 61, paragrafi 1 të Ligjit nr. 06/L-086 rregullon „ Pas parashtrimit të propozimit nga njëra palë, Dhoma e Posaçme mund të caktojë një masë të sigurimit me kusht që parashtruesi jep prova të besueshme për ekzistimin e kërkesës apo të së drejtës subjektive të tij dhe se do të ketë dëme të menjëhershme dhe të riparueshme për palën nëse nuk miratohet masa e sigurimit. Dëmi konsiderohet si i “pariparueshëm” vetëm nëse nuk mund të zhdëmtohet në mënyrë të arsyeshme me anë të një kompensimi financiar. Propozimi për caktimin e masës së sigurimit duhet dorëzuar së bashku me kërkesën, ose nëse dorëzohet pas parashtrimit të një kërkesë/padie, atëherë ajo duhet t’i referohet asaj kërkesë/ padie ”.

Gjykata vlerësoi se paditësi/ propozuesi i sigurimit, përkundër Urdhrit C- III-15- 0188, dt. 25.01.2021, të cilin e ka pranuar i autorizuari i paditësit më dt. 01.02.2021, gjithashtu përkundër kërkesës me të cilën ka kërkuar një afat më të gjatë për të vepruar sipas urdhrin ai nuk veproi, nuk ka precizuar saktë palujatëshmerit që ka kërkuar te Autoriteti i Likuidimit, sikundër edhe në ankesë kundër Vendimit të AL PRN 115- 0188, nuk ka dorëzuar formularin kërkesë kreditore, pastaj nuk ka dorëzuar ekspertizën gjeodezike për të identifikuar saktë ngastrat, sikundër edhe historiatin e ngastrave, me të cila prova do ti argumentonte pretendimin se kanë qenë pronë e paraardhësit të tij, ndërsa provat e dorëzuara në kopje të pa vërtetuara, me këto prova nuk ka sqaruar fare raportin juridiko civil në mes paraardhësit të paditësit dhe të paditurit NSH „Ratar ” dhe kundër propozuesve, kështu që paditësi sipas parimit të barrës së provës nuk e ka bërë fare të besueshëm e kërkesën e tij.

Në lidhje me rrezikun e pretenduar se atij pa u caktuar masa e sigurimit do ti shkaktohej dëm të riparueshëm , edhe këtë kriter nuk e ka bërë të besueshëm, ndaj NSH –së, ndërsa ndaj kundër propozuesve të tjerë , tani më edhe në supozim se kërkesa do të ishte e besueshme, rreziku veç

është shkaktuar pasi sipas Certifikatave të pronës disa nga kundër propozuesit si pronarë ata ngastrat, i kanë regjistruar si hipotek në emër të bankave .

Gjykata vlerëson se për caktimin e masës së sigurimit janë të nevojshme të plotësohen dy kushte ligjore dhe atë :

- Propozuesi i masës së sigurimit, duhet të jep prova të besueshme për ekzistimin e kërkesës apo të drejtës subjektivë dhe
- Propozuesi duhet të jep prova, që pa caktimin e masës së sigurimit do të ketë dëme të menjëhershëm dhe të pa riparueshëm, e që sipas kësaj dispozite dëmi i pa riparueshëm është vetëm nëse nuk mund të zhdëmtohet në mënyrë të arsyeshme me anë të një kompensimi financiar .

Gjykata vlerëson se sipas nenit 31.5 të Ligjit nr. 06/L 086, pala e cila e pohon ekzistimin e një fakti, ajo është e obliguar të paraqes prova fizike dhe /ose dëshmuese për mbështetjen e atij pohimi.

Në rastin konkret propozues i masës së sigurimit, deri në këtë fazë të procedurës, nuk ka ofruar prova që e bëjnë të besueshme kërkesën e tij, ndërsa në lidhje me rrezikun, rreziku është shkaktuar me vendosje të disa ngastrave në hipotekë.

Gjykata me rastin e vendosjes për masë të sigurimit, pa paragjykuar përfundimin e kësaj çështje juridike në lidhje me ankesën e paditësit kundër Vendimit të AL për NSH Ratar në lidhje me ligjshmërinë e Vendimit, vlerëson se propozimi për caktimin e masës së sigurimit tani për tani nuk ka bazë juridike pasi nuk janë plotësuar kushtet ligjore sipas nenit 61 të Ligjit nr. 06/L-086, dhe për këtë arsye edhe është refuzuar propozimi .

Këshillë Juridike:

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës në afatin kohor prej 15 ditëve duke llogaritur nga data e pranimit të këtij aktvendimi.

Hasim Sogojeva, Gjyqtar kryesues

Manushe Karaqi , Gjyqtare

Sylejman Shumolli, Gjyqtar